

## Forumi i INTOSAI WGEPPP zhvilluar në Bernë, Zvicër më datë 26-28 shtator

Në datat 26-28 Shtator 2022, në Bernë, Zvicër, u zhvillua Forumi i INTOSAI-t i Grupit të Punës për Vlerësimin e Politikave Publike dhe Programeve (*WGEPPP – Working Group on Evaluation of Public Policies and Programs*). Në këtë Forum morën pjesë 85 auditues nga 35 SAI të ndryshme të botës.

KLSH u përfaqësua në këtë takim ndërkombëtar me z. Aulent Guri dhe znj. Ermira Vojka. SAI francez e ka kryesuar *WGEPPP* për shumë vite dhe prej marsit 2022, Zyra Federale e Auditimit të Zvicrës (*Swiss Federal Audit Office - SFAO*) ka marrë drejtimin e *WGEPPP*, kalim i cili u zyrtarizua në Paris, gjatë punimeve të konferencës ndërkombëtare për të ardhmen e Evropës, në prani të znj. Margit Kraker, Presidente e SAI-t të Austrisë dhe Sekretare e Përgjithshme e INTOSAI-t.

*WGEPPP* është pjesë e INTOSAI-t dhe synon të përmbushë objektivat e tij strategjike të shkëmbimit të njohurive, si dhe t'u sigurojë SAI-ve të interesuar informacione, mjete metodologjike dhe shembuj praktikash të mira. Në këtë mënyrë bëhet i mundur shkëmbimi i praktikave të mira në fushën e vlerësimit të politikave, shpërndarja e informacionit dhe promovimi i njohurive ndërmjet SAI-ve.



Gjatë punimeve të këtij Forumi u trajtuan tematika dhe punime të ndryshme si: avantazhet e përdorimit të metodave të ndryshme në shkencat sociale, rëndësia e auditimit në një botë, e cila është duke ndryshuar, rëndësia e përdorimit të teknologjisë në auditim dhe avantazhet dhe përfitimet që ato sjellin në rritjen dhe përmirësimin e cilësisë së gjetjeve dhe konkluzioneve të auditimeve, etj.

Audituesit e KLSH morën pjesë gjithashtu në *workshopin* me temë: “Gjetja e çështjeve dhe mënyrave për bashkëpunime në auditime paralele ndërkombëtare”, objektivi i të cilit ishte të identifikonte çështje të mundshme auditimi, të cilat përshtaten në nivel ndërkombëtar dhe mbi të cilat, mund të zhvillohen auditime të përbashkëta.